



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PERMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 6 datë 23.09.2026

**PER PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA FONDI 6%
DHE FONDI I BASHKISË**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore",të ndryshuar,të ligjit nr.57/2019,"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar me ligjin nr.79/2023,datë 12.10.2023 të vendimit nr.597,datë 04.09.2019,të Këshillit të Ministrave"Për përcaktimin e procedurave,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike"të ndryshuar. Familjet do të përzgjidhen në bazë të kriterëve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe masa e pagesës do të llogaritet në bazë të Udhëzimit Nr. 4 datë 17.02.2017. Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë mbi Kriteret e përcaktuara për familjet në nevojë dhe që do të trajtohen nga fondi 6% dhe nga fondet e akorduara nga Bashkia.,

VENDOSI:

1. Familje me një prind me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë.
2. Persona të vetmuar në moshë para pensionit dhe s'kanë të ardhura të tjera.
3. Familje me më shumë se një fëmijë të lindur njëherësh (binjakë, trinjakë, katërnjakë) dhe pa të ardhura financiare.
4. Familje të divorcuara të cilat janë me urdhër mbrojte nga gjykata.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR

Agila DHIMITRI

